



REPubLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 7298/2722/620 regj. themeltar

1932
15.04.2016
Nr. 683 vendimi

Dt. 31.03.2016

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja
Anëtar: Artur Malaj
Anëtare: Lindita Sinanaj

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Ivi Halipaj, sot më dt. 31.03.2016 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shoqëria "Biffer & Co" sh.p.k

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat

Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ (njoftim-vlerësimi), për detyrimet tatimore nr. 1967 prot, datë 31.05.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat dhe vendimin nr. 14435/ prot, datë 31.10.2012 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

BAZA LIGJORE: Nenet 324 e vijues të K.Pr.C dhe nenet 106, 107, 108, 109 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" dhe K.Pr.Administrative.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me vendimin përfundimtar nr. 306, datë 17.03.2014, ka vendosur:

- Rrëzimin e kerkese padise si të pabazuar në prova dhe në ligj.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim te palës paditëse.

- Kundër vendimit lejohet ankimi brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

Kundër vendimit ka bërë ankim pala paditëse, e cila kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe përcaktimin e detyrimit në bazë të aktit të ekspertimit në shumën totale 285 439 lekë, duke parashtruar këto shkaqe ankimi:

- Vendimi i Gjykatës është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit procedural, fakteve, rrethanave si dhe provave të ndodhura në dosje.
- Gjykata nuk ka marrë në konsideratë kundërshtimet e paditësit, në lidhje me Njoftimin për Vlerësimin Tatimor dhe nuk i ka analizuar ato në bazë të ligjit, duke dhënë një vendim jo të plotë dhe të përsyetur.
- Në vendimin e saj Gjykata nuk ka marrë në shqyrtim aktin e ekspertimit të ndodhur në dosje, i cili është urdheruar po nga vete Gjykata dhe ka qenë përcaktues në arritjen e një përfundimi, duke qenë se në bazë të nenit 224/a të K.Pr.Civile kjo çështje kërkon njohuri të posaçme teknike në fushën e kontabilitetit dhe të financave për të arritur në një përfundim sa më të saktë.
- Gjykata nuk ka zhvilluar një gjykim të drejtë e të plotë në përputhje me nenin 14 të KPC, gjithashtu ajo nuk ka marrë në konsideratë një provë të rëndësishme siç është akti i ekspertimit, ndaj kërkohet marrja si provë e këtij akti të ekspertimit nga Gjykata Administrative e Apelit gjatë shqyrtimit të çështjes.
- Lidhur me llogaritjen e gjobës për pjesën “Blerje të perjashtuara e me tvsh jo të zbritshme” këto lloje shpenzimesh nuk krijojnë të ardhura dhe sitë tilla nuk situacionohen, prandaj zbulimi i trajtuar në këtë pikë të Raportit të Kontrollit Përfundimtar nuk qëndron dhe detyrimet tatimore nga 126632 leke duhet të behen zero leke, ashtu si e ka nxjerrë dhe akti ekspertimi.
- Konkluzioni i Raportit të Kontrollit për “Blerje me tvsh nga furnituro vendas”, nuk qëndron dhe detyrimet tatimore nga 41250 leke duhet të behen zero leke.
- Qëndron pjesërisht konkluzioni i Raportit të Kontrollit për konstatimin “Diferencë inventari material Hekuri” dhe detyrimet tatimore duhet të ndryshojnë nga 269352 leke duke u bërë në 168345 leke.
- Konkluzioni i Raportit të Kontrollit për “Importe muaji Janar 2011” qëndron pjesërisht dhe detyrimet tatimore duhet të ndryshojnë nga 271699 leke duke u bërë në 60899 leke.
- Zbulimi i trajtuar sipas Raportit të Kontrollit “Diferencë inventari material hekuri date 19.04.2012”, qëndron pjesërisht dhe detyrimet tatimore duhet të ndryshojnë nga 125280 leke në shumën 16530 leke.
- Zbulimi i trajtuar sipas Raportit të Kontrollit “Deklarimi i fitimit minimal fiskal në ndërtim” për objektin godine banimi Berat”, qëndron pjesërisht dhe detyrimet tatimore duhet të ndryshojnë nga 476107 në 39 665 leke.
- Pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat duhet të bëjë ndryshimet e pasqyruara në aktin e ekspertimit për çdo rastë dhe të bëjë sistemin e tepricave, duke i pasqyruar efektet e ndryshimeve të detyrimeve tatimore në llogaritjet e subjektit.

- Gjykata nuk ka marrë në konsideratë konkluzionet e nxjerra nga eksperti dhe nuk ka hetuar sic duhet kete çeshtje duke pare karakterin e saj teknik. Paditësi kërkon marrjen ne konsiderate të akt – ekspertimit, ndodhur ne dosje, duke vendosur përcaktimin e detyrimit ne baze te aktit te ekspertimit ne shumën totale prej 285 439 leke.

Përpara zhvillimit të seancës në dhomë këshillimi, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë, në zbatim të nenit 49/2 të Ligjit 49/2012, ka sjellë parashtrime me shkrim në të cilat kërkon prishjen e vendimit dhe rrëzimin e padisë.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtarja Alkelina Gazidedja, dhe shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi,

VËREN:

Se pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur për gjykim çështja administrative me palë dhe objekt të sipërcituar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, në bazë të ankimit të bërë nga pala paditëse.

Gjykata së pari, verifikoi ankimin e bërë nga pala paditëse nëse i plotëson kushtet e pranueshmërisë, edhe pse ky fakt është verifikuar me vendimin dt. 07.04.2014 të gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Vlorë, sipas kërkesave të nenit 46 - 48/2 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", dhe konstatoi se ankimi i plotëson kushtet e pranueshmërisë.

Rrethanat e faktit

Nga aktet në dosje rezulton se pala paditëse shoqëria "Biffer & CO" sh.p.k është regjistruar si person juridik me vendim nr. 8751, datë 08.02.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt kryesor të veprimtarisë: "Shërbime në fushën e ndërtimit si ndërtime e rikonstruksione të objekteve sociale, kulturore, ndërtime e rikonstruksione të tjera infrastrukturore si rrugë, ura, vepra të bonifikimit e vaditjes, ndërtim e rikonstruksione banesa etj. Prodhim, përpunim lëndë të parë, produkte të gatshme të industrisë tekstile, mekanike ushqimore, kimike përpunim të lëndëve të para bujqësore e blegtorale, inerte, hoteleri, turizëm elektrike, import eksporti etj". Ky subjekt është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT K32515037A.

Nga pala e paditur është ushtruar një kontroll ndaj palës paditëse për detyrime tatimore, tatim fitimin, TVSH dhe Sigurimet Shoqërore për periudhën 2010-2012.

Nga kontrolli i ushtruar, pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, nëpërmjet njoftim vlerësimit tatimor nr.1967 prot., datë 31.05.2012 ka njoftuar palën paditëse se duhet të paguajë shumën 1.502.646 leke si pasojë e mospagimit të detyrimeve tatimore dhe kamatëvonesave ndër vite.

y akt administrativ, i është komunikuar palës paditëse në datë 04.06.2012 siç rezulton nga vërtetimi i lëshuar nga Posta Shqiptare sh.a, Filiali Berat, datë 26.03.2013.

Ndaj njoftim vlerësimit tatimor nr.1967 prot, datë 31.05.2012, pala paditëse Shoqëria "Biffer & CO" sh.p.k Tiranë, pasi ka bërë të gjithë pagesat e detyrimeve së bashku me interesat përkatëse (kamatëvonesat) ka ushtruar të drejtën e ankimit, pranë Drejtorisë të Apelimit Tatimor, përmes dërgimit me postë rekomande të ankimit më datë 02.07.2012, referuar dëftesës së pranimit të objekteve postare nr.127311, datë 02.07.2012.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendim nr.14435/1 prot, datë 03.10.2012 ka vendosur: "Refuzimin e ankimit, për shkak se e konsideron ankimin e papranueshëm, pasi nuk është respektuar afati ligjor për bërjen e ankimit; Kundër këtij vendimi, bazuar në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në R.SH" neni 109 lejohet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni".

Paditesi duke mos qënë dakort i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me kërkesë padinë objekt gjykimi, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ (njoftim-vlerësimi), për detyrimet tatimore nr. 1967 prot, datë 31.05.2012 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, dhe vendimin nr. 14435/ prot, datë 31.10.2012 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila me vendimin nr. 1444, date 30.12.2013, bazuar në nenin 61 të K.Pr. Civile dhe ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" si dhe Vendimit Unifikues nr. 3, datë 06.12.2013 të Gjykatës së Lartë, ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje, duke dërguar aktet për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me vendimin përfundimtar nr. 306, datë 17.03.2014, ka vendosur sipas dispozitivit të mësipërm.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala paditëse, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe përcaktimin e detyrimit në bazë të aktit të ekspertimit në shumën totale 285 439 lekë.

Arsyetimi i gjykatës

Kolegji administrativ i Gjykatës Administrative të Apelit çmon se, vendimi objekt gjykimi është marrë në shkelje të rënda procedurale, ndaj vendimi duhet të priset dhe çështja të kthehet për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për sa më poshtë vijon:

Në Nenin 79/a Kodi i Procedurës Civile, parashikon se:

"....Gjykata, që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim".

Neni 50 i ligjit nr. 49/2012 parashikon:

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit në dhomë këshillimi

Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos:

ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në rastet kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit".

Nga aktet në dosje rezulton se, palë të paditura në këtë proces janë Drejtoria Rajonale Tatimore Berat dhe Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë. Në këto kushte, Avokatura e Shtetit është insitucioni që bazuar në ligjin nr. 10018, dt. 13.11.2008, neni 5, mbron interesat ekonomike shtetërore, prandaj, bazuar në nenin 79/a të K.Pr.C, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, duhet të njoftonte që në seancën e parë Avokaturën e Shtetit (gjykata që shqyrton çështje për të cilat me ligj përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, urdhëron njoftimin e akteve kësaj të fundit, me qëllim që ajo të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim).

Ky kolegji konstaton se, gjykata në këtë rast nuk e ka zbatuar këtë nen, pasi nga procesverbalet dhe provat e tjera në dosje, del qartë që Gjykata nuk e ka thirrur Avokaturën e Shtetit, prandaj ky kolegji e konsideron procesin gjyqësor të kryer nga gjykata, në shkelje të dispozitave të sipërcituara.

Mungesa e Avokaturës së Shtetit, si rezultat i moszbatimit të nenit 79/a të K.Pr.Civile nga ana e Gjykatës, është trajtuar gjithashtu nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, si më poshtë:

Gjykata e Lartë me Vendimin Unifikues nr. 13, dt. 24.03.2004, ka mbajtur qëndrimin se:

Kolegjet e Bashkuara konstatojnë gjithashtu se, Avokaturës së Shtetit, e cila sipas ligjit nr. 8851, dt.18.11.1999, ka për detyrë të përfaqësojë dhe mbrojë në gjyq shtetin, në kundërshtim me urdherimet e dispozites të nenit 79/a të K.Pr.C, nga ana e gjykates nuk i janë njoftuar aktet, me qëllim që ajo të kishte mundësinë të merrte pjesë në gjykim.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite (neni 79/a të K.Pr.C) del se, kur shqyrton çështje për të cilat përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, gjykata është e detyruar që të urdhërojë njoftimin e akteve kësaj të fundit. Vetëm kështu mund t'i krijohet mundësia reale e Avokaturës së Shtetit, që të marrë pjesë në gjykim, me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit, në rastet e parashikuara nga ky ligj.

Gjykata Kushtetuese, me Vendimin nr. 27, dt. 27.07.2009, ka mbajtur qëndrimin se: "Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave publike nga ana e Avokatures së Shtetit, në një gjykim të filluar, është një përfaqësim dhe mbrojtje e detyrueshme dhe gjykatat, sipas nenit 79/a të KPr.C, kanë detyrimin t'i njoftojnë aktet Av.Shtetit, me qëllim që jo vetëm të marrë pjesë në gjykim, por edhe të realizojë mbrojtjen e interesave të shtetit".

Kurse në nenin 54, gërma "d" e ligjit Nr. 49/2012 është parashikuar se, Gjykata Administrative e Apelit prish vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë dhe ia dërgon çështjen organit kompetent për rigjykim kur gjykata ka shkelur dispozitat lidhur me përfaqësimin e palëve. Në rastin në gjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka shkelur rëndë rregullat mbi përfaqësimin e organeve të administratës shtetërore nga Avokatura e Shtetit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e sipercituara të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit Nr. 10018/2008.

Për sa kohë që gjykimi në shkallë të parë është kryer në shkelje të rënda procedurale, mungesa e njoftimit të Avokaturës së Shtetit, (shkelja e dispozitave të nenit 79/a të K.Pr.Civile), ky kolegj arrin në përfundimin se nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë janë lejuar shkelje të rënda procedurale, të cilat e bëjnë të pavlefshme procedurën e gjykimit, në kuptim të nenit 50/ç të ligjit nr. 49/2012, ndaj Vendimi nr. 306, datë 17.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet të priset dhe çështja të kthehet për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Në rigjykim gjykata duhet të plotësojë të gjitha shkeljet procedurale të sipercituara, të cilat njëherësh përbëjnë dhe detyrat në rigjykim.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Administrative e Apelit, në bazë të nenit 49 e 50/ç të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI:

- Prishjen e vendimit nr. 306, datë 17.03.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
- Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

U shpall sot më dt. 31.03.2016 në Tiranë.

ANËTARE

Lindita SINANAJ
DV

ANËTAR

Artur MALAJ
DV

KRYESUESE

Alkelina GAZIDEDJA
DV

E NJESUAR ME ORIGJINALIN

Alkelina Gazidedja
Artur Malaj
Lindita Sinanaj